



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI

№ 7351 Pakt.
dt. 27.11.2019

URDHËR

Nr. 153, datë 25.11.2019

PËR

MARRJEN E MASAVE DHE RREGULLIMIN E DISPOZITAVE LIGJORE PËR APLIKIMIN E SHËRBIMEVE VETËM ON-LINE NGA DATA 1.1.2020

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të pikës 1, të nenit 12, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave",

URDHËROJ:

1. Të gjitha institucionet në nivel qendror të marrin masat që deri në datën 1.12.2019 të hartojnë listën me të gjitha aplikimet *on-line* të shërbimeve që mund të ofrohen vetëm në Portalin Qeveritar e-Albania.
2. Brenda datës 1.12.2019, të gjitha institucionet në nivel qendror të përcjellin pranë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit listën e formularëve të aplikimit dhe dokumenteve shoqëruese për çdo aplikim shërbimi që do të ofrohet vetëm *on-line* në Portalin Qeveritar e-Albania.
3. Të gjithë ministrat të nxjerrin urdhrat përkatës me masat konkrete që duhet të marrin për të përshtatur kuadrin ligjor për nxjerrjen/aplikimin e dokumentit *on-line*, duke i bashkëlidhur atyre listën e aplikimeve të shërbimeve të cilat nga data 1.1.2020 do të ofrohen vetëm *on-line* në Portalin Qeveritar e-Albania.
4. Të gjitha institucionet qendrore, brenda 3 (tri) ditëve të punës nga marrja e kërkesës nga institucionet kërkuuese, t'iu vënë atyre në dispozicion dokumentet shoqëruese të kërkuara.
5. Personat e autorizuar, që do të përdorin sistemin, me qëllim kërkimin dhe/ose ofrimin e dokumenteve shoqëruese, duhet të pajisen nga AKSHI me

kredenciale për përdorimin e modulit të administratës dhe/ose kredencialet e sistemit të qarkullimit të dokumenteve me nënshkrim elektronik.

6. Të gjithë titullarët e institucioneve, të cilët lëshojnë dokumente që janë shoqëruese për aplikimet që do të jenë vetëm *on-line*, nga data 1.1.2020 duhet të pajisen me nënshkrim elektronik dhe të përcjellin kërkesën pranë AKSHI-t, brenda datës 1.12.2019.
7. Të gjitha institucionet në nivel qendror të përcjellin pranë AKSHI-t, brenda datës 1.12.2019, listën e punonjësve të autorizuar për t'u pajisur me kredencialet e modulit të administratës dhe/ose kredencialet e sistemit të qarkullimit të dokumenteve me nënshkrim elektronik, sipas formularit të përcaktuar në faqen zyrtare në *web* të AKSHI-t.
8. Të gjitha institucionet në nivel qendror të koordinohen për të mundësuar informimin dhe sensibilizimin e publikut mbi aplikimet e shërbimeve që do të ofrohen vetëm *on-line* në Portalin Qeveritar e-Albania.
9. Posta Shqiptare, sh.a., ADISA dhe të gjitha institucionet e shërbimeve qendrore dhe vendore duhet të asistojnë aplikuesit për dërgimin e aplikimeve të shërbimeve që do të ofrohen vetëm *on-line* në Portalin Qeveritar e-Albania.
10. Dërgimi i dokumenteve shoqëruese fizike, në rastet kur është i nevojshëm për përfitimin e shërbimeve publike do të bëhet nëpërmjet Postës Shqiptare, sh.a.
11. Ngarkohen të gjitha institucionet në nivel qendror për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

EDIRAMA



NR.PROT. 5841
DATË 27.11. 2019

TË GJITHA MINISTRIVE DHE INSTITUCIONEVE
TË TJERA QENDRORE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGAÇI

